



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
I SANKSIONEVE

Data: 3 Prill 2021

Nr: 18

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 11, DATË 02.04.2021  
TË PARTISË DREJTËSI, INTEGRIM DHE UNITET NDAJ VENDIMIT TË  
KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE NR. 193, DATË 31.03.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 03.04.2021, me pjesëmarrjen e:

Koli BELE	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

**Ankues:** Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet

**OBJEKT:** Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 11, të Partisë 'Drejtësi, Integrim dhe Unitet' me objekt "Ndryshimin e vendimit nr. 193, datë 31.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve 'Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021' duke vendosur pjesëmarrjen e Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet në shortin për anëtarin e katër të GNV-së".

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, pika 1, shkronja "b" 123/1, pika 2, 124, 126, 129, 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe nenet 17, shkronja "a", 18 dhe 30 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 "Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve".



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjo diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

#### **VËREN:**

Ankuesi Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr, 11 regj., datë 02.04.2021.

Në mbledhjen e datës 03.04.2021, ora 10:45 pas relatimit të z. Koli Bele dhe diskutimit të përfaqësuesit të subjektit ankues, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 11 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në mbështetje të nenit 17 pika 3, shkronja “a” të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, Kërkesa Ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

#### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17 pika 3, shkronja “a” e 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”,

#### **V E N D O S I:**

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 11, datë 02.04.2021, të paraqitur nga Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 06.04.2021, në orën 11:00
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

**Koli BELE** - **Relator**

**Elvin LAKO** - **Anëtar**

**Elvis ÇEFA** - **Anëtar**

**Ilirjan RUSMALI** - **Anëtar**

**Ledio BRAHO** - **Anëtar**

